

*Lutemi plotësoni
informacionin më poshtë
dhe dërzojani priftit.*

Data që kërkoni për shërbimin:

Emri i plotë i personit që do të pagëzohet:

Emri i pagezimit (nqs është ndryshe):

Ditëlindja dhe vëndlindja:

Emri i Babait:

Emri i Nënës (me mbiemrin e lindjes):

Adresa:

Nr. i Telefonit:

E-mail:

Emri i Nunit:

Emri i Nunës:

Adresa:

Nr. i Telefonit:

E-mail:



PAGËZIMI

Hyrja Në Kishë



*Të gjithë ata që janë Pagezuar me
Krishtin, kanë ndjekur rrugën e
Krishtit.*

Duke iu bindur dhe imituar Krishtin, Krishterët Ortodoks i bashkohen trupit të kishës nëpërmjet kungatës së shenjtë të pagezimit. Uji i shenjtë i pagezimit është një simbol i vdekjes tonë por në te njejtën kohë është shpresa në Ringjalljen e Krishtit-Perëndia jonë i cili është ringjallur. Edhe pse ky akt mund të shihet vetëm si nje zakon, është sigurisht më shumë se atë. Pagezimi është nje orientim i ri ne jetën e një personi, duke kaluar nga jeta e tij ose e saj që në lindje në një jetë krishtere e cila bën të mundur shpëtimin.

Duke qënë një akt i tille, pagezimi kërkon sakrificë dhe angazhim. Për të rriturit kjo do të thotë pjesëmarrje besnike në aktivitetet dhe veprimtarinë e kishës nëpërmjet shërbimeve, lutjeve, keshmave, dhe festave të saj. Për fëmijet, me qënë se ata nuk kanë mundesi t'i ndërmarrin vetë këto angazhime, do të thotë që përgjegjësia bie mbi prindët dhe nunët e tyre.

Nunët janë të përgjegjshëm për mirëqënien shpirtërore të fëmijëve që ata kanë pagëzuar. Në kishë kjo lidhje konsiderohet edhe më e afërt sesa lidhja e gjakut. Prandaj nunët duhet të jenë fetarë krishtere ortodoks dhe pjesëmarrës të rregullt në veprimtaritë e shenjta te kishës, sic jane rrëfimi dhe kungimi.

Gjithashtu prindët duhet të kuptojnë se sjellja e fëmijeve të tyre në besimin kristian do të ndryshojë prioritetin e veprimtarive të fëmijevë. Fëmijët duhet të angazhohen me pjesëmarrjen e rregullt të shërbimeve të kishës dhe punës për të siguruar që feja që praktikohet të djelave në kishë të praktikohet edhe në shtëpi



Pagezimi është tregues i një jetë ndryshe nga ajo e jetuar që ne lindje prandaj dhe kërkon disa detyrime përpara dhe mbas kryerjes së këtij veprimi të shenjtë:

Familja duhet të programojë një takim me priftin përpara pagezimit në një ditë përveç të djelës në mëngjes.

Nunët duhet të takohen me priftin përpara pagezimit.

Të djelën përpara pagezimit familja duhet të jetë prezente për një provë të shkurtër.

Ai ose ajo që do pagëzohet duhet të frekuentojë gjithë shërbimet e të djelave muajin mbas pagëzimit.

Ai ose ajo që sapa është pagëzuar e ka të detyrueshme të ndjekë shërbimet e kishës të pakten një herë në muaj mbas pagëzimit

Pagezimi nuk është një ngjarje por një hyrje në jetën krishtere e cila kërkon disipline dhe konsistence. Sigurohuni që fëmija juaj të mos jetë krishterë vetëm nga emri.



Ka disa objekte që janë të nevojshme për pagezim. Nuk është e nevojshme që këto objekte të jenë me ornamente zbukurimi. Këto sende duhet t'i sjelli familja ose nunët.

- Varëse kryqi
- Qiri të madh
- Shishe të vogël me vaj ulliri
- Peshqir të madh
- Veshje të bardhë për fëmijen

Ju lutemi pyesni priftin për të caktuar datën dhe orarin e pagezimit sa më shpejt të jetë e mundur dhe përpara se të ftoni rrethin familjar dhe shoqëror.